FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 112 30 gusht 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 473, datë 25.7.2012	Për dhënien në përdorim Inspektoratit Qendror të një pjese të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit dhe dhënien në përdorim Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike të një pjese të godinës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve.....	6495
Vendim i KM nr. 475, datë 25.7.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave "Për shtypjen e letrave me vlerë", të ndryshuar.....	6499
Vendim i KM nr. 476, datë 25.7.2012	Për një ndryshim në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", të ndryshuar.....	6499
Vendim i KM nr. 478, datë 25.7.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shushicë, të qarkut të Vlorës.....	6500
Vendim i KM nr. 481, datë 25.7.2012	Për miratimin e rregullores "Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese".....	6501
Vendim i KM nr. 483, datë 3.8.2012	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me një ekip shëndetësor në operacionin ushtarak "ISAF", Afganistan.....	6504

Vendim i KM nr. 486, datë 25.7.2012	Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2012-2015 dhe përcaktimin e përgjegjësisë institucionale për përafrimin në legjislacionin shqiptar të çdo akti të legjislacionit të Bashkimit Europian……	6505
Vendim i KM nr. 487, datë 25.7.2012	Për rregullat dhe procedurat e skemës së financimit e bashkëfinancimit të transfertës së pakushtëzuar për mbështetjen e gjelbërimit……	6506
Vendim i KM nr. 488, datë 25.7.2012	Për autorizimin e "Rametal" sh.p.k. për importin e mbetjeve metalike të aluminit për qëllime riciklimi……	6507
Vendim i KM nr. 489, datë 25.7.2012	Për autorizimin e "Everest IE" sh.p.k. për importin e mbetjeve të polietilenit, për qëllime riciklimi……	6508
Udhëzim i KM nr. 1, datë 18.7.2012	Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara……	6509
Urdhër i KM nr. 87, datë 27.7.2012	Për lirimin dhe emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Kombëtar të Punësimit……	6513
Udhëzim i MB nr. 259, datë 30.7.2012	Për marrjen dhe bashkërendimin e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik, si dhe për marrjen e masave ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe në zonat turistike e bregdetare……	6513
Udhëzim i MPÇSSHB nr. 5, datë 1.8.2012	Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror……	6518

VENDIM
Nr. 473, datë 25.7.2012

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM INSPEKTORATIT QENDROR TË NJË PJESE TË GODINËS SË OBSERVATORIT TË INSTITUTIT TË GJEOSHKENCAVE DHE ENERGJISË, UJIT E MJEDISIT DHE DHËNIEN NË PËRDORIM AGJENCISË KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE TË NJË PJESE TË GODINËS SË ISH-MINISTRISË SË TRANSPORTEVE E TELEKOMUNIKACIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr. 8743, datë 23.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim Inspektoratit Qendror të katit zero teknik të godinës së observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Dhënien në përdorim Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike të katit zero teknik të godinës së ish-Ministrisë së Transporteve dhe Telekomunikacioneve, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lirojnë mjediset përkatëse.
4. Vendimi nr. 655, datë 28.9.2011 i Këshillit të Ministrave "Për dhënien në përdorim Inspektoratit Qendror të një pjese të godinës së ish-Ministrisë së Transporteve e Telekomunikacioneve", shfuqizohet.
5. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Brendshme, Inspektorati Qendror, Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike dhe Instituti i Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


PJESE NGA RELIEVI I TIRANES, SHK. 1: 500, VITI 1982,
AZHORNUAR NE VITIN 1993, MARRE NGA PLANSHETA P-7.
Fushë Volejbolli
2T
1T
2KT
2 KT
Meteorologjiku
1KT
1KQ
46/2
92,34
46/1
92,56
46
92,73


LABORATORI
PLANIMETRIA E KATIT TE PARE E RINGJALLJES
SHKALLA 1:100

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Institucioni I Pushtetit Qendror : **Akademia e Shkencave**

Bashkia : **Tirane**

Fusha e perdorimit te Prones : **Administrate**

Supervizoi: **Florian Progri** (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Fadil Kepi** (Shef I Sekt. te Pergj.te Ak.Shkencave)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1			Truall ndertese	Instituti I Informatikes dhe Matematikes se Aplikuar Rr."Lek Dukagjini" Tirane	7644	1740	Administrate	Akademia e Shkencave	INIMA	
2			Truall ndertese	Instituti I Kerkimeve Biologjike Rr."Irfan Tomini" Tirane	1704	500	Jasht funksioni	Akademia e Shkencave	Instituti Kerkimeve Biologjike	Zene forcerisht
3			Truall ndertese	Instituti I Gjuhesise dhe Letersise Rr."Naim Frasheri" Nr.7 Tirane	1245	830	Administrate	Akademia e Shkencave	Instituti Gjuhesise dhe Letersise	Ne te njejten godine ndodhen Instituti I Gjuhes dhe Letersise Instituti I Historise
4			Truall ndertese	Instituti I Hidrometeologjise Tirane	699.8	508.75	Administrate	Akademia e Shkencave	Instituti Hidrometeologjise	
5			Truall ndertese	Godina e Observatorit Rr."Fransua Plaku" Tirane	3700	667.4	Ruajtje vrojtime	Akademia e Shkencave	Instituti Hidrometeologjise	

VENDIM
Nr. 475, datë 25.7.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 1497, DATË 19.11.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 "Për akcizat", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të pikës 1 të vendimit nr. 1497, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave të lojërave të fatit ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, sipas një procedure të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

Me pamundësi të kapacitetit teknologjik nënkuptohet mungesa e *software-ve* dhe *hardware-ve* të nevojshëm për shtypjen e biletave të lojërave të fatit.

Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit, për të cilat Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes, ajo mbledh bordin drejtues, i cili analizon ekonomikisht në mënyrë të hollësishme, pamundësinë e shtypjes së këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik, nëse do të investohej për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste. Në përfundim, bordi drejtues i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i cili i komunikohet operatorit kërkues. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja të akredituara, brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 476, datë 25.7.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 55, DATË 3.2.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DEKLARIMIN E DETYRUESHËM TË DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 65 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5.3 e vendimit nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5.3. Subjektet që janë të detyruara të deklarojnë dhe të paguajnë kontributet e sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, duhet të dorëzojnë në organet tatimore, brenda afateve ligjore edhe në formë shkresore, listëpagesat dhe të dhënat për ndryshimin e numrit të punonjësve për të gjitha periudhat tatimore të vitit 2012.

Për këto periudha tatimore, për efekt të zbatimit të afateve të deklarimit, do të vlerësohet dokumenti i dorëzuar apo i deklaruar më i pari në organin tatimor.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 478, datë 25.7.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SHUSHICË, TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shushicë, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Shushicë, të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr. 1381, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shushicë, të qarkut të Vlorës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Shushicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Shushicë — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve shëndetësore	Në pronësi
15-24	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
25-68, 807-1311	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
69-502	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
503-507	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi

585-598,614,619-654,659-667,677,680-684,689-692,694-699,709,716-725,728-729,741,743-751,765,768-778,786-801	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
1312-1319	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 481, datë 25.7.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR SIGURINË E PUBLIKUT NDAJ EKSPOZIMEVE QË SHKAKTOHEN NGA BURIMET E RREZATIMEVE JONIZUESE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR SIGURINË E PUBLIKUT NDAJ EKSPOZIMEVE QË SHKAKTOHEN NGA BURIMET E RREZATIMEVE JONIZUESE

1. Objekti i rregullores

Kjo rregullore përcakton rregullat për sigurinë e publikut ndaj ekspozimeve që shkaktohen nga burimet e rrezatimeve jonizuese, të detyrueshme për zbatim në të gjitha veprimtaritë e përcaktuara me ligj.

2. Përgjegjësitë e personave fizikë e juridikë të licencuar

2.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar për ushtrimin e veprimtarive me burime të rrezatimit jonizues zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe të standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, për çdo ekspozim të publikut që shkaktohet nga praktika ose burime për të cilët ata janë përgjegjës. Personat fizikë e juridikë të licencuar zbatojnë kërkesat e përcaktuara nga Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet për ekspozimet ose burimet mbi nivelet e përjashtimit, qofshin dhe ekspozime ose burime natyrore.

2.2 Personat fizikë e juridikë të licencuar janë përgjegjës për burimet nën përgjegjësinë e tyre, për përgatitjen dhe zbatimin e:

a) politikave të mbrojtjes dhe sigurisë, sistemit procedural dhe organizativ në lidhje me ekspozimin e publikut në përmbushje të kërkesave të standardeve;

b) masave që sigurojnë:

i) optimizmin e mbrojtjes së publikut, ekspozimi i të cilit lidhet me këto burime; dhe

ii) kufizimin e ekspozimit normal për grupet kritike përkatëse që lidhet me këto burime, në mënyrë që ekspozimi total të jetë jo më i lartë se doza kufi për publikun. Në zgjedhjen e grupeve kritike duhet të merren parasysh të gjithë brezat e tanishëm ose të ardhshëm në vendet ku ndodhen burimet apo dhe në vende të tjera;

c) mundësisë që ekspozimi i publikut të kontrollohet në përputhje me kërkesat e standardeve;

d) ndërtesave, pajisjeve dhe shërbimeve të përshtatshme dhe bashkëkohore për mbrojtjen e publikut, natyra dhe shtrirja e të cilave janë në përpjesëtim me vlerën dhe mundësinë e ekspozimit;

e) trajnimeve të përshtatshme për mbrojtjen dhe sigurinë e personelit, i cili ka funksione që lidhen me mbrojtjen e publikut, si dhe të trajnimeve periodike dhe bashkëkohore, me qëllim që të sigurojnë nivelin e nevojshëm të kompetencës;

f) pajisjeve monitoruese të përshtatshme dhe të programeve mbikëqyrëse për të vlerësuar ekspozimin e publikut sipas kërkesave të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet;

g) regjistrimit të të dhënave të inspektimeve dhe monitorimeve;

h) planit dhe procedurave të emergjencave, në përputhje me natyrën dhe madhësinë e riskut dhe mbajtjen e tyre në gatishmëri për t'i aktualizuar në përputhje me Planin Kombëtar të Emergjencës.

2.3 Personat e licencuar janë përgjegjës për të siguruar që procesi i optimizimit për masat e kontrollit të shkarkimit të lëndëve radioaktive nga vendi i ruajtjes në mjedis është subjekt i dozave shtrënguese, duke marrë parasysh:

a) kontributin e dozës nga burime dhe praktika të tjera;

b) ndryshimet e mundshme të ndonjë kushti, i cili mund të ndikojë në ekspozimin e publikut, ndryshimet në karakteristikat dhe punën me burimet, ndryshime në mënyrat e ekspozimit, ndryshime në mënyrën e jetesës dhe të shpërndarjes së popullsisë, modifikimin e grupeve kritike ose ndryshime në kushtet e mjedisit;

c) praktikën më të mirë në punën me burime ose praktika të ngjashme.

2.4 Nëse një praktikë ose një burim brenda praktikës shkarkon lëndë radioaktive në mjedis, që mund të shkaktojë ekspozim të publikut në një vend të ndryshëm nga vendi ku praktika ose burimi është vendosur, kërkohet optimizmi dhe kontrolli i shkarkimeve.

3. Kontrolli i vizitorëve

3.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar në bashkëpunim me punonjësit:

a) do të sigurojnë informacionin dhe instruksionet e nevojshme për vizitorët para hyrjes së tyre në zonat e kontrolluara, në mënyrë që të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme të vizitorëve dhe të individëve të tjerë, të cilët mund të ndikohen nga veprimet e tyre;

b) do të sigurojnë që vizitorët të jenë shoqëruar në çdo zonë të kontrolluar nga një person që ka njohuri për masat mbrojtëse dhe të sigurisë në këto zona;

c) do të sigurojnë vendosjen e një kontrolli për hyrjen e vizitorëve në zonat e mbikëqyrura dhe vendosjen e shenjave të përshtatshme në këto zona.

4. Burimet e ekspozimit të jashtëm

4.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar në rastin kur një burim i rrezatimit të jashtëm mund të shkaktojë ekspozim të publikut sigurojnë:

a) kryerjen e ekspertizave të pavarura përpara fillimit të punës për planimetritë e mjedisit dhe sistemimin e pajisjeve për të gjitha instalimet e reja dhe për të gjitha modifikimet e rëndësishme në instalimet ekzistuese që përdorin burime të rrezatimit të jashtëm;

b) vendosjen e dozave shtrënguese për punën e këtyre burimeve;

c) optimizimin e mbrojtjes nga rrezatimet.

5. Ndotjet radioaktive në hapësira të mbyllura

5.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar sigurojnë që:

a) për burimet për të cilat ata janë përgjegjës, masat për mbrojtje të jenë optimizuar në përputhje me kërkesat e standardeve;

b) zbatojnë kërkesat për të parandaluar shpërndarjen e ndotjeve në zonat ku ndodhet publiku.

6. Mbetjet radioaktive

6.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar:

a) sigurojnë që aktiviteti dhe volumi i çdo mbetjeje radioaktive që rezulton nga burimet për të cilat ata janë përgjegjës, të mbahet në minimumin e mundshëm dhe që mbetjet të menaxhohen (grumbullohen, trajtohen, kondicionohen, transportohen, ruhen dhe depozitohen) në përputhje me rregulloren për menaxhimin e sigurt të mbetjeve;

b) ndajnë dhe trajtojnë veçmas, kur është e nevojshme, llojet e ndryshme të mbetjeve

radioaktive. Për ruajtjen e përkohshme deri në depozitimin përfundimtar, merren në konsideratë faktorë të ndryshëm të tillë si përmbajtja e radionuklidit, perioda e përgjysmimit, përqendrimi, vëllimi dhe vetitë fizike dhe kimike.

7. Shkarkimi i lëndëve radioaktive në mjedis

7.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar sigurojnë që lëndët radioaktive nga burimet dhe praktikat e licencuara nuk duhet të shkarkohen në mjedis derisa:

a) shkarkimi është brenda kufijve të shkarkimit të autorizuar;

b) shkarkimet janë të kontrolluara;

c) ekspozimet e pritshme të publikut nga shkarkimet janë të kufizuara në jo më shumë se 10 mikroSivert në vit;

d) kontrolli i shkarkimeve është optimizuar në përputhje me kërkesat kryesore të standardeve.

7.2 Personat fizikë e juridikë të licencuar, përpara se të fillojnë shkarkimin në mjedis të lëndëve radioaktive të ngurta, të lëngëta ose të gazta nga burimet që janë nën përgjegjësinë e tyre:

a) përcaktojnë karakteristikat dhe aktivitetin e materialeve që do të shkarkohen, pikat e mundshme dhe mënyrat e shkarkimit;

b) përcaktojnë nëpërmjet studimeve paraprake të përshtatshme, të gjitha rrugët e ekspozimeve të rëndësishme nëpërmjet të cilave shkarkimet e radionuklideve kontribuojnë në ekspozimin e publikut;

c) vlerësojnë dozën në grupet kritike, që vjen nga shkarkimet e planifikuara;

d) paraqesin këtë informacion te Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

7.3 Personat fizikë e juridikë të licencuar, gjatë kohës së punës me burimet që janë nën përgjegjësinë e tyre:

a) mbajnë, në nivelet më të ulëta të mundshme, të gjitha shkarkimet radioaktive nën kufijtë e autorizuara të shkarkimeve;

b) monitorojnë shkarkimin e radionuklideve për të treguar përputhjen me kufijtë e autorizuar të shkarkimeve;

c) regjistrojnë rezultatet e monitorimit;

d) raportojnë rezultatet e monitorimit te Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet.

7.4 Personat fizikë e juridikë të licencuar, rishikojnë dhe rregullojnë masat kontrolluese të shkarkimeve të tyre nga burimet nën përgjegjësinë e tyre në bazë të eksperiencës së punës, duke marrë parasysh çdo ndryshim në rrugët e ekspozimit dhe në përbërjen e grupeve kritike që mund të ndikojnë në vlerësimin e dozave që vijnë nga shkarkimet.

8. Monitorimi i ekspozimit të publikut

8.1 Personat fizikë e juridikë të licencuar:

a) përgatitin dhe zbatojnë një program monitorimi për sa i përket ekspozimit të publikut ndaj rrezatimeve të jashtme;

b) përgatitin dhe zbatojnë një program monitorimi që të sigurohen se kërkesat e standardeve për shkarkimin e lëndëve radioaktive në mjedis mbeten të vlefshme për të bërë të mundur vlerësimin e ekspozimit të grupeve kritike;

c) mbajnë të dhëna të përshtatshme për rezultatet e programeve të monitorimit;

d) paraqesin një raport përmbledhës të rezultateve të monitorimit në Komisionin e Mbrojtjes nga Rrezatimet.

9. Produktet e konsumit

9.1 Produktet e konsumit që mund të shkaktojnë ekspozim ndaj rrezatimit, shpërndahen në publik kur plotësojnë kërkesat e përcaktuara në rregullore të veçanta;

9.2 Furnizuesit e produkteve të konsumit të papërjashtuara sigurojnë që këto produkte plotësojnë kërkesat e standardeve për sa i përket projektimit dhe prodhimit të tyre, të cilat mund të ndikojnë në ekspozimin e publikut gjatë përdorimit, duke mbajtur parasysh:

a) radionuklidet që mund të përdoren, aktiviteti, llojet e rrezatimeve, energjitë si dhe periodat e përgjysmimit të tyre;

b) format fizike dhe kimike të radionuklideve;

c) kufizimin dhe mbrojtjen e materialit radioaktiv në produktet e konsumit

d) eksperiencën që lidhet me produkte konsumi të ngjashme.

9.3 Furnizuesit e produkteve të konsumit që përmbajnë lëndë radioaktive shtesë sigurojnë që të vendosin një etiketë të lexueshme mbi sipërfaqen e dukshme në çdo produkt konsumi, duke treguar:

a) lëndën radioaktive që përmban produkti;

b) autorizimin e Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet për shitjen e produktit në publik.

9.4 Furnizuesit e produkteve të konsumit duhet të japin informacione dhe instruksione të qarta dhe të përshtatshme për çdo product lidhur me:

a) instalimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e saktë të produktit;

b) shërbimin dhe riparimin e tij;

c) radionuklidet që përmbahen dhe aktivitetet e tyre në një datë të caktuar;

d) fuqinë e dozës së rrezatimit gjatë operimit normal si dhe gjatë shërbimit dhe riparimit;

e) rekomandime për procedurat e trajtimit pas kthimit të tyre në mbetje.

VENDIM
Nr. 483, datë 3.8.2012

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME NJË EKIP SHËNDETËSOR NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5 e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një ekipi shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak "ISAF", Afganistan.

2. Autoriteti i drejtimit operacional për ekipin shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kohën e qëndrimit në mision, është Komanda e Ekipit Këshillues Mjekësor të NATO-s (NTM-A), që vepron në Komandën Rajonale Qendrore të Operacionit "ISAF", në Kabul, Afganistan.

3. Misioni i ekipit shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është mbështetja dhe këshillimi i personelit shëndetësor afgan, në Akademinë e Shkencave Mjekësore të Forcave të Armatosura Afgane.

4. Ekipi shëndetësor pjesëmarrës në këtë operacion përbëhet nga 10 (dhjetë) ushtarakë, nga të cilët 2 (dy) mjekë dhe 8 (tetë) infermierë.

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 (një) vit, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të ekipit të parë shëndetësor në mision. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

6. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ekipin shëndetësor pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) shërbimin telefonik celular dhe satelitor, si dhe shërbimin postar;

ç) transportimin e individit/ve të shkëputur të misionit për në atdhe për raste sëmundjesh dhe thyerje disipline;

d) veprimtari social-kulturore;

dh) çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrë pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 486, datë 25.7.2012

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES SË STABILIZIM-ASOCIIMIT, 2012-2015 DHE PËRCAKTIMIN E PËRGJEGJËSISË INSTITUCIONALE PËR PËRAFRIMIN NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR TË ÇDO AKTI TË LEGJISLACIONIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), 2012-2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Integrimit orienton, bashkërendon dhe monitoron zbatimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, 2012-2015 (më poshtë PKZMSA, 2012-2015), si dhe procesin e shpërndarjes së *acquis communautaire* për çdo kapitull nga: ministritë, grupet ndërinstitucionale të punës (GNP), të ngritura me urdhrin nr. 183, datë 11.12.2009 të Kryeministrit "Për krijimin, përbërjen dhe funksionimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për çdo kapitull të *acquis communautaire*, duke përfshirë edhe kapitujt e kriteret politik dhe ekonomik" dhe institucionet e tjera qendrore. Ministria e Integrimit raporton çdo 3 (tre) muaj në Këshillin e Ministrave për ecurinë e procesit.

3. Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore raportojnë pranë Ministrisë së Integrimit, çdo 3 muaj (java e tretë e muajit të fundit), për realizimin e detyrimeve, që rrjedhin nga PKZMSA, 2012-2015 dhe për ecurinë e procesit të përafrimit të *acquis communautaire*.

4. Ngarkohet Ministria e Financave që, në bashkëpunim me Ministrinë e Integrimit, të monitorojë përfshirjen në programin buxhetor afatmesëm të nevojave financiare për zbatimin e përparësive, afatshkurtra dhe afatmesme, të parashikuara në PKZMSA 2012-2015, nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore.

5. Brenda 4 (katër) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, të cilat janë pjesë e grupeve ndërinstitucionale të punës, të përcaktuara në urdhrin nr. 183, datë 11.12.2009 të Kryeministrit, nën koordinimin dhe monitorimin e Ministrisë së Integrimit, të përcaktojnë përgjegjësitë institucionale për përafrimin e çdo akti të legjislacionit të BE-së në legjislacionin e brendshëm.

6. Rregullat më të hollësishme për mënyrën e përcaktimit të përgjegjësive institucionale, për përafrimin e çdo akti të legjislacionit të BE-së në legjislacionin e brendshëm, me propozimin e Ministrit të Integrimit, të miratohen nga KNIE-ja, brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Vendimi nr. 463, datë 5.7.2006 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit", i ndryshuar, shfuqizohet.

8. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, për të cilat në PKZMSA, 2012-2015 janë përcaktuar detyra të veçanta për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 487, datë 25.7.2012

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SKEMËS SË FINANCIMIT E BASHKËFINANCIMIT TË TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR MBËSHTETJEN E GJELBËRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondin prej 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar, të ndarë sipas ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", që komunat dhe bashkitë nuk e kanë përdorur për skemën e financimit të pemëtarisë, duhet ta përdorin për gjelbërim, me qëllim përmirësimin e treguesve të mjedisit.

2. Sipërfaqet që do të gjelbërohen, duhet të ndodhen brenda juridiksionit administrativ të komunës ose bashkisë.

3. Fondi i transfertës së pakushtëzuar, i përcaktuar në pikën 1, do të përdoret për:

a) krijimin e parqeve të reja apo rehabilitimin e atyre ekzistuese, por që kanë humbur funksionin si të tilla, duke i pyllëzuar me drurë të ndryshëm pyjorë;

b) gjelbërimin e territoreve publike të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore, rrugëve, institucioneve dhe objekteve të ndryshme social-kulturore;

c) pyllëzimin e territoreve të kërcënuara nga ndotjet industriale;

ç) pyllëzimin e sipërfaqeve të eroduara, të rrezikuara nga rrëshqitjet dhe që paraqesin rrezik për infrastrukturën dhe zonat e banuara apo ato industriale;

d) pyllëzimin e shtretërve të lumenjve dhe kthimin e tyre në zona rekreative për njerëzit apo prodhimin e biomasës me cikël të shkurtër prodhimi për energji të rinovueshme;

dh) pyllëzimin e sipërfaqeve përreth varrezave;

e) pyllëzime të integruara me kultura bujqësore e kullosore për krijimin e sistemeve agro-pyjore e silvo-pastorale.

4. Sipërfaqet që do të përdoren për krijimin e parqeve apo zonave të gjelbëruara, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) të jenë pronë publike e patjetërsueshme;

b) të mos jenë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;

c) të mos jenë objekt tjetërsimi si pasojë e investimeve publike të miratuara më parë;

ç) të mos jenë objekt i studiuar dhe i miratuar për ndërtime urbane apo vepra industriale;

d) të jenë të lidhura me infrastrukturë rrugore.

5. Llojet e drurëve që do të mbillen, duhet të plotësojnë kërkesat, si më poshtë:

a) t'u përshtaten kushteve klimatike tokësore në zonën ku do të mbillen;

b) përparësi t'u jepet specieve me përdorim kompleks (frutore-pyjore) ose llojeve tradicionale e autoktone, që synojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurinë ushqimore;

c) fidanët të jenë të certifikuar.

6. Në rastet kur sipërfaqet që do të pyllëzohen për t'u kthyer në park apo zonë të gjelbëruar janë fond pyjor në pronësi shtetërore, Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të akteve ligjore, t'i kalojë këto sipërfaqe në pronësi të komunave dhe bashkive.

7. Komunat apo bashkitë fondin e transfertës së pakushtëzuar duhet ta planifikojnë për t'u përdorur brenda vitit buxhetor, duke realizuar projektet përkatëse për pyllëzimin e sipërfaqeve, për krijimin e parqeve dhe zonave të gjelbëruara dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni.

8. Skema e financimit të projekteve me fondin e transfertës së pakushtëzuar të jetë në përputhje me nivelin e realizimit të punimeve për pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve për t'u kthyer në parqe dhe zona të gjelbëruara.

9. Komunat dhe bashkitë, pas punimeve për mbjelljen e drurëve pyjorë, duhet të kryejnë të gjitha shërbimet për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e këtyre objekteve.

10. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të bashkëpunojë me njësitë e qeverisjes vendore, duke monitoruar punimet që do të kryhen sipas fazave deri në realizimin e plotë të tyre dhe të hartojë një raport për Ministrinë e Financave.

11. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe komunat e bashkitë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 488, datë 25.7.2012

PËR AUTORIZIMIN E "RAMETAL" SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË ALUMINIT PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e "RAMETAL" sh.p.k., për importin e mbetjeve metalike të aluminit për qëllime riciklimi, me Kodin Doganor:

- GA 760200 mbetje të aluminit;
- GA 76020011 mbetje të aluminit;
- GA 76020019 mbetje të aluminit;
- GA 76020090 kthime të aluminit;

dhe kodin B1-B1010 të Konventës së Bazelit, sipas anekseve 1 e 2, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi".

2. Sasia e mbetjeve metalike të aluminit që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 25 000 tonë.

3. Mbetjet importohen nga vendet e Bashkimit Europian, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e

mbetjeve për importimin, përpunimin dhe riciklimin". Ambalazhimi i tyre të bëhet në paleta, i presuar ose në thasë plastikë konform aneksit III të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi". Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, "RAMETAL" sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Kohëzgjatja e lejimit të importit të mbetjeve metalike të aluminit nga "RAMETAL" sh.p.k. të jetë për një periudhë kohore 1-vjeçare dhe të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, të marrë masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të aluminit nga "RAMETAL" sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore, për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasie të mbetjeve të aluminit, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre", në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 489, datë 25.7.2012

PËR AUTORIZIMIN E "EVEREST IE" SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE TË POLIETILENIT, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e "EVEREST IE" sh.p.k. për importin e mbetjeve të polietilenit me Kodin Doganor GH 011 ex 391510 dhe Kodin e Konventës së Bazelit B3-B3010, sipas anekseve 1 e 2, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi".

2. Sasia e mbetjeve të polietilenit që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4 500 (katër mijë e pesëqind) tonë.

3. Mbetjet importohen nga vendet e BE-së. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe në përputhje me kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve, përpunimin dhe riciklimin".

4. Periudha kohore e lejimit të importit të mbetjeve të polietilenit nga "EVEREST IE" sh.p.k., të jetë 1 (një)-vjeçare, periudhë, e cila fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, të marrë masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të polietilenit nga "EVEREST IE" sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato në të cilat do të transitojë kjo sasi e mbetjeve të polietilenit, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit "Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre", në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 1, datë 18.7.2012

PËR PROCEDURAT E DHËNIES ME QIRA TË TOKAVE BUJQËSORE TË PANDARA

Në mbështetje të neneve 100 e 102 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" dhe të pikës 4 të vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për tokat bujqësore të pandara", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. Objekti dhe subjektet në procesin e dhënies me qira të tokave bujqësore

1. Objekt i qiradhënies sipas këtij udhëzimi janë:

a) tokat bujqësore, të cilat në datën 1.8.1991 janë regjistruar si të tilla në regjistrat kadastralë, si dhe kanë qenë në përbërje të ish-kooperativave bujqësore dhe kanë mbetur pa u ndarë sipas dispozitave të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", për shkak të refuzimit të marrjes së tyre në pronësi nga familjet bujqësore;

b) sipërfaqet e tokave të dhëna në pronësi të komunave ose bashkive, të regjistruara në regjistrat kadastralë në kategorinë e resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe sipërfaqet e tokave të pafrytshme, të cilat më pas kanë kaluar në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar.

2. Zyra e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT), në komunë ose bashki, evidenton sipërfaqet e tokës bujqësore për dhënie me qira, objekt të pikës 1 të këtij kreu, duke pasqyruar numrin kadastral të ngastrave, madhësinë në hektarë, si dhe vendndodhjen e tyre. Pasqyra me të dhënat e evidentuara, pasi konfirmohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT), në qark, i paraqitet këshillit të komunës ose bashkisë, i cili shqyrton dhe miraton sipërfaqet e tokave bujqësore, që mund të jepen me qira.

3. Kryetari i komunës ose bashkisë ku ndodhet toka bujqësore, objekt i pikës 1 të këtij kreu, në cilësinë e autoritetit qiradhënës, krijon Komisionin e Qiradhënies së Tokës Bujqësore të Pandarë (KQTBP).

4. KQTBP-ja ka në përbërje:

- kryetarin e komunës ose bashkisë — kryetar;
- një përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë — anëtar;

- një përfaqësues të DAMT-së në qark anëtar;
- një specialist të ZMMT-së në komunë ose bashki anëtar;
- një specialist jurist në komunë ose bashki anëtar.

5. Kryetari i komunës ose bashkisë, në cilësinë e autoritetit qiradhënës, ka për detyrë:

a) shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet për marrjen me qira të tokës, si dhe marrjen e vendimit nga komisioni, brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim;

b) organizimin e procedurës së garës, si dhe garantimin e barazisë për subjektet pjesëmarrëse, kur për të njëjtën tokë bujqësore është paraqitur më shumë se një kërkesë për qiramarrje;

c) shpalljen dhe njoftimin e vendimit të marrë për qiradhënien pranë komunës ose bashkisë ku ndodhet toka bujqësore, objekt i qiradhënies;

ç) lidhjen e kontratës tip me subjektin e përzgjedhur;

d) verifikimin e respektimit të kushteve të përcaktuara në kontratën tip gjatë të gjithë kohëzgjatjes së saj.

6. Kërkesa për marrjen me qira të tokës bujqësore, objekt i këtij udhëzimi, mund të bëhet nga çdo person, fizik dhe juridik, vendas ose i huaj.

7. Toka bujqësore, objekt i këtij udhëzimi, jepet me qira vetëm në rastet e shfrytëzimit të saj për veprimtari bujqësore.

8. Në çdo rast, për madhësinë e sipërfaqes së tokës bujqësore, që jepet me qira për një subjekt kërkues, zbatohen kriteret e përcaktuara në pikën 1 të kreut IV të këtij udhëzimi.

II. Procedurat që ndiqen nga KQTBP-ja për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara

1. Çdo subjekt, i përcaktuar në pikën 6 të kreut I të këtij udhëzimi, i cili kërkon të marrë me qira një tokë bujqësore të pandarë, paraqet pranë komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën bujqësore, një kërkesë me shkrim drejtuar kryetarit të komunës ose bashkisë, ku të përfshihen edhe:

- të dhënat e kërkuesit;
- sipërfaqja dhe vendndodhja e tokës bujqësore, e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me numrat kadastralë përkatës, të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me numrin e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme (ZVRPP);
- afati i qirasë;
- veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose speciet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;
- aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve;
- investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.;
- burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare;
- ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;
- propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).

2. Kërkesës i bashkëlidhet vërtetimi i lëshuar nga DAMT-ja e qarkut, ku tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral, si dhe jepet informacioni për gjendjen e pronësisë së saj. Gjithashtu, kërkesës i bashkëlidhet një plan i hollësishëm i zhvillimit të biznesit.

3. Me marrjen e kërkesës së parë për qiramarrje të tokës bujqësore, kryetari i komunës ose i bashkisë menjëherë fton me shpallje publike pranë komunës ose bashkisë, sipas shkronjës "c" të pikës 5, kreu I të këtij udhëzimi, të interesuarit të depozitojnë kërkesat e tyre për marrjen me qira të së njëjtës tokë bujqësore, brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga data e shpalljes. Kryetari i komunës, në të njëjtën shpallje, njofton edhe datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurës së garës, e cila duhet të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit 10-ditor për paraqitjen e kërkesave.

4. Me kalimin e afatit 10-ditor të paraqitjes së kërkesë-ofertave, të përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu, kryetari i komunës ose i bashkisë thërret mbledhjen e KQTBP-së me pjesëmarrjen e plotë të të

gjithë anëtarëve të tij, në datën e caktuar për zhvillimin e garës. Çdo anëtar i komisionit është i detyruar të paraqitet në mbledhjen e KQTBP-së sipas njoftimit. KQTBP-ja, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të paraqitjes së kërkesave sipas pikës 3 të këtij kreu, duhet të vlerësojë kërkesat dhe të marrë vendimin përkatës.

5. Kur pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij kreu, është paraqitur vetëm një kërkesë për marrje me qira të tokës bujqësore, atëherë KQTBP-ja e shqyrton atë në datën e përcaktuar për garën dhe merr vendimin përkatës.

6. Veç anëtarëve të komisionit, në momentin e hapjes së kërkesë-ofertave mund të marrin pjesë edhe ofruesit ose përfaqësuesit e tyre, të pajisur me prokurë dhe dokument identifikimi.

7. KQTBP-ja i vlerëson kërkesë-ofertat e paraqitura bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) Teknologjinë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe në përpunimin e produkteve;

b) Investimet kryesore mbi infrastrukturën (kullim, ujitje, sistemimin etj.), të shprehura në tregues, fizikë dhe monetarë, si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve dhe me përpunimin e produkteve etj.;

c) Ndikimin e investimit në rritjen e numrit të të punësuarve në komunën ose bashkinë përkatëse;

ç) Propozimin për çmimin e ofruar për marrjen e tokës bujqësore me qira (lekë/ha në vit).

8. KQTBP-ja, gjatë vlerësimit të ofertave sipas pikës 7 të këtij kreu, vlerëson me përparësi disponimin e mundshëm nga kërkuesi, të statusit të subjektit të shpronësuar, i njohur si i tillë me vendim të institucioneve përkatëse të ngarkuara me ligj, në lidhje me sipërfaqen, objekt i kërkesës për qiramarrje.

9. Mënyra e përllogaritjes së kritereve të vlerësimit të kërkesë-ofertave për marrjen me qira të tokës bujqësore, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. Çmimi dysheme i dhënies së tokës bujqësore me qira, si në rastin e paraqitjes së një kërkese, ashtu dhe në rastin e paraqitjes së dy ose më shumë kërkesave për të njëjtën sipërfaqe, nuk mund të jetë më i ulët se 6 000 (gjashtë mijë) lekë/ha, në një vit kalendarik.

11. Vendimi i KQTBP-së për dhënien me qira të tokës bujqësore është i vlefshëm kur për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit. Vendimi i KQTBP-së përgatitet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e tij. Vendimi përmban klasifikimin dhe pikët e të gjitha kërkesave të shqyrtuara së bashku me arsyetimet përkatëse, si dhe evidenton kërkesën fituese. Vendimi shpallet menjëherë pranë komunës ose bashkisë, si dhe u njoftohet subjekteve pjesëmarrëse.

12. Çdo subjekt, i cili ka paraqitur kërkesë për marrje toke bujqësore me qira, objekt i shkronjës "a" të pikës 1 të kreut I të këtij udhëzimi, ka të drejtë të ankohet për vendimin e KQTBP-së te Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Kundër vendimit të KQTBP-së në lidhje me kërkesën për marrje toke me qira, objekt i shkronjës "b" të pikës 1 të kreut I të këtij udhëzimi, bëhet ankim pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet toka, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

13. Ministri shqyrton ankimimin e subjektit të interesuar, të bërë sipas paragrafit të parë të pikës 12 të këtij kreu, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së tij dhe, kur e vlerëson të drejtë, urdhëron kryetarin e komunës ose bashkisë për ripërsëritjen e procedurave të shqyrtimit të kërkesave nga KQTBP-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së urdhrit.

14. Pas mbarimit të afateve të përcaktuara në pikën 12 të këtij kreu, bazuar në vendimin e KQTBP-së, lidhet kontrata tip e qirasë ndërmjet kryetarit të komunës ose bashkisë, në cilësinë e autoritetit qiradhënës, dhe subjektit të përzgjedhur, në cilësinë e qiramarrësit.

III. Procedurat që ndiqen në rastet kur funksionet e autoritetit qiradhënës ushtrohen nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

1. Në rastin kur kryetari i komunës ose i bashkisë nuk ndërmerr veprimet e parashikuara në krerët I dhe II të këtij udhëzimi, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e regjistrimit të kërkesës, funksionet e autoritetit qiradhënies i ushtron Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, nëpërmjet strukturave në varësi të tij, vetëm për sipërfaqet, objekt i shkronjës "a" të pikës 1 të kreut I të këtij udhëzimi.

2. Subjekti i interesuar për marrjen me qira të tokës bujqësore e shpreh interesin e tij nëpërmjet një kërkese me shkrim që i drejtohet Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Kërkesa paraqitet në përputhje me përcaktimet e pikave 1 dhe 2 të kreut II të këtij udhëzimi.

3. Kërkesa e subjektit të interesuar i kalon për shqyrtim Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë (DRB), në juridiksionin e së cilës ndodhet toka bujqësore, objekt i kërkesës, me anë të urdhrit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili ngarkon DRB-në me realizimin e procedurave të dhënies së tokës me qira.

4. Drejtori i DRB-së, në zbatim të urdhrit të ministrit, krijon një grup pune prej tre specialistësh të DRB-së dhe një përfaqësues nga DAMT-ja e qarkut, i cili, nën drejtimin e drejtorit të DRB-së, ndërmerr veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon dhe saktëson në DAMT-në e qarkut të dhënat për pronësinë e tokës bujqësore të kërkuar për qiradhënie, si dhe madhësinë e sipërfaqes së saj sipas numrave kadastralë;

b) Në zbatim të procedurave dhe afateve të parashikuara nga pika 3 deri në pikën 9 të kreut II të këtij udhëzimi, shqyrton dhe vlerëson kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara. Shpalljet dhe njoftimet publike bëhen pranë DRB-së;

c) Pas përfundimit të shqyrtimit të kërkesave nga grupi i punës, drejtori merr vendimin, i cili përmban klasifikimin dhe pikët e të gjitha kërkesave të shqyrtuara, si dhe evidenton kërkesën fituese për dhënien e tokës bujqësore me qira në përputhje me pikën 10 të kreut II të këtij udhëzimi. Vendimi i dërgohet menjëherë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe u njoftohet subjekteve pjesëmarrëse në garë.

5. Ministri i shqyrton në çdo rast të gjitha vendimet e drejtorit të DRB-së për dhënien me qira të tokës bujqësore dhe, kur këto i gjen të rregullta, i miraton me urdhra të veçantë, duke autorizuar edhe drejtorin e DRB-së përkatëse për nënshkrimin e kontratës së qirasë. Urdhrat shpallen pranë DRB-së përkatëse.

6. Çdo subjekt, i cili ka paraqitur kërkesë për qiramarrje të tokës bujqësore, ka të drejtë të ankohet në lidhje me procedurat e zhvillimit të konkursit pranë ministrit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të drejtorit të DRB-së.

7. Në bazë të urdhrit të ministrit, drejtori i DRB-së, në cilësinë e personit të autorizuar nga autoriteti qiradhënës, lidh kontratën për dhënien me qira të tokës bujqësore me subjektin e përzgjedhur, në cilësinë e qiramarrësit. Një kopje e kontratës së lidhur i dërgohet kryetarit të komunës ose bashkisë në juridiksionin e të cilit ndodhet toka, objekt i kontratës së qirasë.

IV. Afatet e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara dhe sipërfaqet përkatëse

Tokat bujqësore të pandara jepen me qira për afate kohore, si më poshtë vijon:

a) Deri në 10 (dhjetë) vjet, kur destinohen për kultivim të bimëve të arave, eterovajore dhe bimëve dekorative. Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes së tokës bujqësore që jepet me qira nuk mund të jetë më e vogël se madhësia e sipërfaqes së parcelës, sipas së cilës rezulton e regjistruar në dokumentacionin kadastral të DAMT-së, ose sa madhësia e sipërfaqes së parcelës, sipas së cilës ajo reflektohet në hartën treguese të tokës "HTR", pranë ZVRPP-së.

b) Deri në 35 (tridhjetë e pesë) vjet, kur destinohen:

i) për krijimin dhe kultivimin e vreshtave;

ii) për krijim pemëtoresh me specie dru frutorë, mosha biologjike e të cilëve përkon me këtë kohëzgjatje kultivimi dhe me rentabilitet ekonomik;

iii) për ndërtim serrash e kultivim të bimëve në to;

iv) për fidanishte.

Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes që jepet me qira, nuk mund të jetë më e vogël se 0.5 ha.

c) Deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet, kur destinohen:

i) për krijim ullishteje;

ii) për krijim pemëtoreje me dru frutorë, si kulturat arrore dhe specie të tjera, mosha biologjike e të cilave përkon me këtë kohëzgjatje.

Në këtë rast, madhësia e sipërfaqes që jepet me qira, nuk mund të jetë më e vogël se 1 ha.

V. Dispozitat e fundit

1. Përmbajtja dhe forma e kontratës tip të qirasë, që lidhet ndërmjet autoritetit qiradhënës dhe subjektit të përzgjedhur, miratohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Pavarësisht se cili është autoriteti qiradhënës, pagesa nga ana e subjekteve qiramarrëse e qirasë së tokave bujqësore të pandara, sipas këtij udhëzimi, bëhet për llogari të komunës ose bashkisë, e cila ka në përdorim tokën, objekt i qirasë.

3. Udhëzimi nr. 3, datë 16.5.2007 i Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", shfuqizohet.

4. Ngarkohen kryetarët e komunave ose bashkive për dhënie informacioni te DAMT-ja e qarkut për qiradhënie të tokave bujqësore të pandara, në dhjetor të çdo viti.

5. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryetarët e komunave ose bashkive, në juridiksionin e të cilave ndodhen tokat bujqësore të pandara, objekt i qiradhënies, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr. 87, datë 27.7.2012

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Z.Thoma Miço, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të lirohet nga kjo detyrë.

2. Z.Ilir Ibrahimi të emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 259, datë 30.7.2012

PËR MARRJEN DHE BASHKËRENDIMIN E MASAVE PËR MBARËVAJTJEN E SEZONIT TURISTIK, SI DHE PËR MARRJEN E MASAVE NDAJ SUBJEKTEVE QË GJENEROJNË ZHURMË TEJ NORMAVE TË LEJUARA NË QENDRAT URBANE DHE NË ZONAT TURISTIKE E BREGDETARE

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ligjit nr. 8927, datë 25.7.2002 "Për Prefektin", të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të ligjit nr. 9734, datë 14.5.2007 "Për turizmin", të ligjit nr. 7664, datë 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin

e zhurmës në mjedis", të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar, të ligjit nr. 10 220, datë 4.2.2010 "Për shpalljen e moratoriumit për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë", të aktit normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25.7.2012, të vendimit nr. 343, datë 12.5.2010 të Këshillit të Ministrave "Për mjetet motorike lundruese që lejohen të qarkullojnë në zbatim të moratoriumit "Për mjetet motorike lundruese të Republikës së Shqipërisë" dhe të vendimit nr. 587, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane e turistike", vendimit nr. 358, datë 1.6.2012 të Këshillit të Ministrave "Për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit", me qëllim:

Krijimin dhe garantimin për qytetarët të kushteve sa më të mira të sigurisë, ambienteve e standardeve për pushime në zonat turistike dhe përmbushjen e përgjegjësive nga ana e strukturave të Ministrisë së Brendshme, organeve të qeverisjes vendore, si dhe institucioneve të tjera në nivel vendor, për periudhën e sezonit turistik veror dhe menaxhimit të zhurmave në qendrat urbane, zonat turistike dhe bregdetare ose jo, gjatë gjithë vitit,

UDHËZOJ:

I. Funksionimin e shtabeve të punës të ngritura me këtë udhëzim të Ministrit të Brendshëm dhe bashkërendimin e masave për garantimin e rendit dhe rritjen e sigurisë publike dhe menaxhimit të zhurmave në qendrat urbane, zonat turistike dhe bregdetare gjatë gjithë vitit, për plotësimin e standardeve për pushime në zonat turistike dhe qendrat e banuara, të kryesuar nga prefektët dhe me përbërje:

- Kryetarin e Këshillit të Qarkut;
- Kryetarin e Bashkisë/Komunës;
- Drejtorin e Policisë së Qarkut;
- Drejtorin Rajonal të Kufirit dhe Migracionit;
- Drejtorin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
- Shefi i Njësisë Rajonale të Policisë Rrugore;
- Shefin e PMNZSH-së për qarkun;
- Drejtorin Rajonal të Shërbimit Parësor;
- Drejtorin Rajonal të Rrugëve;
- Drejtorin Rajonal të Doganave;
- Drejtorin Rajonal të Bujqësisë;
- Drejtorin Rajonal të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- Komandantin e Batalionit të Mbështetjes Rajonale.

Hartimin dhe miratimin e një plani masash dhe plani veprimi, të detajuar sipas strukturave përkatëse, për zbatimin e detyrave të caktuara nga shtabi i punës, brenda muajit mars të çdo viti.

II. Në zbatim të aktit normativ të Këshillit të Ministrave, datë 25 korrik 2012, të krijohet brenda muajit korrik 2012, pranë çdo prefekti/nënprefekti me detyrë ekskluzive, Task Forca për marrjen e masave të menjëhershme për përballimin e situatës së krijuar nga ushtrimi i aktiviteteve ekonomike që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara, në qendrat urbane, zonat turistike dhe bregdetare, e cila do të funksionojë gjatë gjithë vitit.

Task Forca drejtohet nga prefekti/nënprefekti me detyra ekskluzive të juridiksionit përkatës dhe ka këtë përbërje:

a) inspektorë të njësive inspektuese të Inspektoratit të Mjedisit;

b) punonjës të shërbimeve të Policisë së Shtetit;

c) inspektor të Policisë së Bashkisë dhe Komunës;

ç) specialist të Institutit të Shëndetit Publik dhe strukturave vendore të shëndetit publik;

d) inspektorë të Inspektoriatit Shtetëror të Punës.

Mbi detyrat e Task Forcës:

1. Task Forca ushtron aktivitetin e saj çdo ditë të javës, duke ndaluar ushtrimin pas orarit të lejuar të veprimtarive të subjekteve, fizike dhe juridike, të cilat janë burim zhurme, si dhe në rastet e

njoftimit nga institucionet shtetërore apo komuniteti për tejkalim të normave të lejuara të nivelit të zhurmës në mjedis.

2. Për mjediset e hapura orari i lejimit të veprimtarive për ditët e premte dhe të shtuna të jetë nga ora 19:00 deri në orën 24:00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19:00 deri në orën 23:30 sipas normave të lejuara të zhurmës, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr. 8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3. Për mjediset e mbyllura veprimtaria lejohet duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në udhëzimin e përmendur në pikën 2.

Detyrat e strukturave të Prefektit, të Policisë së Shtetit dhe njësive të qeverisjes vendore si pjesë e Task-Forcës:

1. Strukturat e Policisë së Shtetit, si pjesë e Task-Forcës, mbështetin veprimtarinë e Inspektoratit të Mjedisit për ekzekutimin e vendimeve për të cilat ligji i posaçëm parashikon dënime administrative plotësuese, pezullim të aktivitetit dhe sekuestrim të pajisjeve dhe impianteve të subjekteve, që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin nr. 9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis" dhe aktet ligjore në fuqi.

2. Në rastet kur subjektet kundërshtojnë ndërprerjen e aktivitetit, ekzekutimin e vendimeve të Inspektoratit të Mjedisit ose pengojnë kryerjen e matjes së zhurmës nga specialistët e Institutit të Shëndetit Publik, veprohet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", si dhe për rastet kur veprimet e subjekteve përbëjnë vepër penale, materialet i referohen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor.

3. Strukturat ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore, si dhe strukturat e Policisë së Shtetit marrin masa ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me aktin normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25.7.2012, duke bashkëpunuar dhe duke bashkërenduar punën për garantimin e qetësisë publike në këto zona.

4. Ngarkohen prefektët/nënprefektët me detyra ekskluzive, njësitë e qeverisjes vendore dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij akti normativ.

5. Moskryerja e detyrës së ngarkuar nga punonjësit e strukturave të përcaktuara më sipër (nenin 2 të aktit normativ të Këshillit të Ministrave), konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

I. Strukturat e Policisë së Shtetit brenda muajit prill të çdo viti marrin këto masa:

1. Strukturat e Policisë së Shtetit në përmbushje të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 "Për të huajt" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 1.4.2009 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave dhe të dokumentacionit për hyrjet, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë", të marrin masa për lehtësimin e procedurave të hyrjeve-daljeve dhe qëndrimit të shtetasve të huaj në vendin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

2. Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit dhe ato të Policisë Rrugore të rrisin bashkëpunimin dhe intensifikojnë kontaktet me strukturat homologe policore të Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë dhe Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të përbashkëta për çështjet kufitare, parandalimin e trafiqeve të paligjshme e qenieve njerëzore, kontrollin e përbashkët të akseve rrugore në të gjithë territorin e vendit me shërbimin policor të Kosovës, si dhe kontrollin e lëvizjeve të personave me precedentë policorë dhe penalë.

3. Në varësi të fluksit të udhëtarëve dhe mjeteve në PKKK-të, drejtuesit e drejtorive rajonale të kufirit dhe migracionit të zhvillojnë takime dypalëshe me strukturat homologe të kufirit, me qëllim shtimin e sporteleve për përballimin dhe menaxhimin e fluksit dhe zgjidhjen e problemeve që mund të lindin.

4. Të merren masat tekniko-logjistike për të siguruar gatishmërinë dhe funksionimin e plotë e të pandërprerë të të gjithë sistemit TIMS, për të siguruar një veprimtari normale dhe pa pengesa në regjistrimin e udhëtarëve në pikat e kalimit kufitar.

5. Strukturat e varësisë së Ministrisë së Brendshme të bashkëpunojnë me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si: dogana, fitosanitarët, roja bregdetare, kapiteneritë, autoritetet portuale, agjencitë private etj., me qëllim lehtësimin e procedurave të kalimit të shtetasve dhe mjeteve gjatë sezonit veror, nëpërmjet një kontrolli efikas të kufirit dhe pa e cenuar sigurinë.

6. Drejtuesit e strukturave qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, si dhe ata të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të raportojnë çdo njoftim, sinjalizim apo ankesë të shtetasve për rastet e abuzimeve me detyrën, shkeljeve të kërkesave të Kodit të Etikës së Policisë, keqsjelljeve, keqtrajtimeve apo shkelje të tjera të të drejtave të qytetarëve nga ana e personelit policor, duke mbajtur qëndrim në përputhje me aktet normative, deri në ndjekje penale.

7. Policia e Shtetit të intensifikojë masat në drejtim të rritjes së sigurisë në rrugë, parandalimit të aksidenteve dhe krijimin e kushteve për një lëvizje e qarkullim pa pengesa të mjeteve e këmbësorëve, sidomos në akset rrugore Durrës-Morinë, Durrës-Qafë Thanë, Durrës-Vlorë, Shkodër-Tiranë, Tiranë-Durrës, Kakavijë-Gjirokastër-Fier-Vlorë ose Durrës dhe Kapshticë-Korçë-Elbasan-Durrës.

8. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ato të qeverisjes vendore dhe agjencitë e tjera të bashkëpunojnë për planifikimin dhe zbatimin e masave të përbashkëta, për dhënien e lejeve dhe monitorimin e aktivitetit të lokaleve të natës, si: disko, pube, duke evidentuar dhe moslejuar shkaktimin e zhurmave, të cilat përbëjnë shqetësim për komunitetin etj.

9. Të bashkëpunohet ngushtë mes strukturave të linjës së Ministrisë së Brendshme me ato të Ministrisë së Punëve Publike e Transporteve, për përmirësimin e infrastrukturës rrugore, sinjalistikës rrugore, rregullimin e menaxhimin e trafikut në qendrat urbane, sipas akteve të pushtetit vendor, si dhe duke kufizuar gjatë periudhës së verës, në zona apo orare të caktuara, lëvizjen e mjeteve të rënda.

10. Të bashkëpunohet ngushtë mes strukturave të linjës së Ministrisë së Brendshme me ato të Ministrisë së Mjedisit dhe Ujërave për zbatimin e vendimeve të marra ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë, në kundërshtim dhe kapërcim të ligjit.

11. Të bashkëpunohet ngushtë mes strukturave të linjës së Ministrisë së Brendshme me ato të pushtetit vendor, që veprimtaritë në det, liqene dhe lumenj, për kanotazh dhe veprimtari të ngjashme, të kryhen vetëm nga persona të autorizuar dhe anëtarësuar në federatat përkatëse.

12. Strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit, në bashkëpunim me drejtoritë e policisë së qarkut dhe kapiteneritë e porteve të marrin masa për evidentimin, regjistrimin dhe pajisjen me dokumentacionin e nevojshëm të të gjithë motorëve të ujit.

13. Drejtuesit e njësive të qeverisjes vendore në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe Migracionit, të marrin masa për:

- përcaktimin e zonës ku motorët e ujit lejohen të përdoren sipas përcaktimit të vijës së plazheve publike dhe/ose private të vëna në dispozicion nga bashkitë dhe komunat;
- vendosjen e shenjave kufizuese (bovat), ku të përcaktohen: vendvendosja, hyrja apo dalja dhe zona e lejuar e lundrimit për motorët e ujit;
- personat që do të pajisen me leje për ushtrimin e këtij aktiviteti, duhet të parashikojnë, sipas rastit, persona, ekuipazhe dhe mjete shpëtimi për aktivitetin e tyre;
- të mos lejohet afrimi i mjeteve lundruese në asnjë zonë ku notojnë pushuesit;
- të jepen lejet e përdorimit të mjeteve lundruese në distancat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 1.6.2012.
- për vendosjen e shenjave kufizuese të bashkëpunohet me Shërbimin Hidrografik Shqiptar.

14. Njësi të patrullave të Policisë së Shtetit dhe asaj Bashkiake nga toka dhe të Policisë Kufitare dhe e Migracionit e Rojës Bregdetare nga deti të bëjnë kontrollin e mjeteve lundruese për:

- mënyrën, kushtet dhe kriteret e përdorimit;
- lëvizjen brenda zonave të kufizuara;
- pajisjen me mjete e ekuipazhe për shpëtimin e pushuesve;
- dokumentacionin e tyre;
- të mos lejojnë largimin dhe afrimin nga/në breg me shpejtësi më të madhe se ajo e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 1.6.2012.
- të mos lejohet afrimi i motorëve të ujit në një distancë më të vogël se ajo e përcaktuar në

vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 358, datë 1.6.2012, te mjetet e tjera lundruese që janë në lundrim, në spirancë, në radat e proteve detare etj.

15. Drejtoritë e policive në qarqe, drejtoritë rajonale të PKM-së dhe bashkitë ose komunat, të marrin të gjitha masat për të ndaluar plotësisht aktivitetin e motorëve të ujit deri në plotësimin e kritereve të parashikuara në pikat 11, 12 e 13 të këtij udhëzimi.

16. Të gjithë motorët e ujit dhe mjetet për kanotazh e veprimtari të ngjashme ujore, të cilët lëvizin pa u plotësuar kriteret e parashikuara në pikat 11, 12 e 13 të këtij udhëzimi, duhet të bllokohen dhe sekuestrohen, duke u konsideruar si aktivitet i jashtëligjshëm.

III. Kryetarët e bashkive dhe komunave, të mbështetur edhe nga kryetarët dhe administrata e këshillave të qarqeve, në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe të aktit normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25 korrik 2012, të akteve të tjera ligjore e nënligjore, brenda muajit prill, të marrin këto masa:

1. Kryetarët e bashkive dhe komunave:

a) për pastrimin e plazhit dhe hyrjet e daljet në zonat turistike nga mbeturinat dhe largimin e tyre;

b) sigurimin e ujit të pijshëm;

c) dhënien e lejeve të lokaleve të ndryshme që shkaktojnë zhurma, në zbatim të aktit normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25 korrik 2012;

- për lokalet e mbyllura pa kufizim orari;

- në të gjitha rastet e kësaj pike, të respektohet niveli i lejuar i zhurmave sipas udhëzimit të përbashkët nr. 8, datë 27.11.2007 të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrisë së Shëndetësisë;

d) të ndihmojnë për sigurimin e trafikut në qarkullimin e makinave dhe njerëzve;

e) sigurimin e shesheve për parkimin e automjeteve;

f) për dhënien e lejeve dhe vendvendsojen e mjeteve motorike të ujit, si dhe kontrollin e qarkullimit të tyre në det;

g) disiplinimin e derdhjeve të ujërave të zeza, depozitimin dhe përpunimin e mbeturinave.

2. Të ngarkojnë strukturat e policisë bashkiake të bashkëpunojnë me strukturat e Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit, për përballimin e trafikut të automjeteve dhe zgjidhjen e çështjeve brenda kompetencave.

3. Të bashkëpunojnë me pronarët e hoteleve, restoranteve, lokaleve publike për të dhënë informacionin e nevojshëm për pushuesit te strukturat e policisë, për të rritur shkallën e sigurisë në zbatim të ligjit.

4. Kryetarët e bashkive dhe komunave që kanë në territorin e tyre plazhe, të krijojnë dhe sigurojnë funksionimin e grupeve të dhënies së ndihmës së shpejtë për gjatë vijës së plazhit në rastet kur rrezikohet jeta e pushuesve nga mbytjet në ujë, rreziku nga zjarri apo aksidente të tjera. Në rrugët hyrëse të plazheve, të vendosen tabelat me numrat e telefonit të shërbimeve të Policisë së Shtetit, të shërbimeve të emergjencës, të zjarrfikësve, grupeve të shpëtimit, si dhe tabela për zonat e rrezikshme për jetën.

5. Në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Rojën Bregdetare të marrin masa për zbatimin e kërkesave të këtij udhëzimi, duke caktuar vende të posaçme për motorët e ujit, si dhe kufizimet në det për lëvizjen e tyre.

6. Masat e marra gjatë këtij sezoni nga pushteti vendor dhe Policia e Shtetit të bëhen publike në mediat lokale apo kombëtare, duke kërkuar dhe bashkëpunimin e publikut për krijimin e një ambienti të qetë dhe të sigurt.

IV. Ndjekja dhe raportimi

Prefektët/nënprefektët me detyra ekskluzive në juridiksionin e tyre:

1. Evidentojnë dhe vlerësojnë informacionet ditore të dërguara nga kryetarët e bashkive dhe komunave, drejtoritë e policisë në qarqe dhe drejtuesit e strukturave shtetërore mbi zbatimin e planit të masave dhe planit të veprimit, si dhe të detyrave të parashikuara në këtë udhëzim.

2. Marrin informacion ditor nga strukturat e Policisë së Shtetit, të zgjedhurit vendor, drejtuesit e strukturave shtetërore në nivel vendor dhe raporton gjatë gjithë periudhës së sezonit turistik nga 15 maji

deri më 30 shtator, çdo të premte, me shkrim në Ministrinë e Brendshme për zbatimin e planit të masave dhe planit të veprimit, si dhe të detyrave të parashikuara në këtë udhëzim.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prefektët/nënprefektët me detyra ekskluzive, shtabet e punës, task forcat, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimit Zjarrfikës, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Integrimit, kryetarët e bashkive dhe komunave, kryetarët e qarqeve, si dhe të gjitha strukturat përgjegjëse të përcaktuara në aktin normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25 korrik 2012.

4. Moskryerja e detyrës së ngarkuar nga punonjësit e strukturave të përcaktuara më sipër (nenin 2 të aktit normativ të Këshillit të Ministrave të datës 25 korrik 2012), konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore dhe përbën shkak për fillimin e procedurave të largimit nga detyra.

5. Ngarkohen zëvendësministrat e brendshëm për ndjekjen dhe monitorimin e këtij udhëzimi.

6. Udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr. 243, datë 8.6.2011 "Për marrjen dhe bashkërendimin e masave për garantimin e rendit, rritjen e sigurisë publike dhe përmbushjen e standardeve gjatë sezonit turistik veror", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Flamur Noka

UDHËZIM
Nr. 5, datë 1.8.2012

PËR NIVELIN E KUOTAVE TË SHPENZIMEVE PËR USHQIME, NË INSTITUCIONET PUBLIKE REZIDENCIALE E KOMUNITARE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 24 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në institucionet rezidenciale publike të përkujdesit shoqëror është:

a)	Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç	300 lekë;
b)	Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 3-6 vjeç	310 lekë;
c)	Për fëmijët e vendosur në shtëpinë e fëmijës 6-15 vjeç	330 lekë;
d)	Për personat e vendosur në qendrat e zhvillimit	340 lekë;
e)	Për të moshuarit e vendosur në shtëpitë e të moshuarve	300 lekë;
f)	Për klientët në qendrat pritëse, rehabilituese dhe riintegruese për viktimat e trafikimit dhe të dhunës sipas kategorive të përfituesve të përcaktuar në germat "a","b","c","d" dhe "e" të këtij udhëzimi.	

2. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për klientët, që përfitojnë shërbime në qendra ditore publike të përkujdesit shoqëror është:

a)	Në qendrat ditore polivalente	160 lekë;
b)	Në qendrat ditore të zhvillimit	220 lekë;
c)	Në shtëpinë e foshnjës 0-3 vjeç	220 lekë;
d)	Në shtëpinë e fëmijës 3-15 vjeç	220 lekë;
e)	në shtëpinë e të moshuarve	160 lekë.

3. Niveli i kuotës financiare për shpenzimet ditore ushqimore për kuzhinierët dhe ndihmëskuzhinierët, që punojnë në këto institucione, është i barabartë me 60% të kuotës financiare ditore për ushqim, për kategoritë e përfituesve të përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi.

4. Efektet financiare nga rritja e nivelit të kuotës financiare të shpenzimeve për ushqim, përballohen nga fondet e buxhetit qendror, të programuara për shërbimet e përkujdesit shoqëror për vitin 2013.

5. Udhëzimi nr. 1547, datë 11.12.2009 "Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale dhe komunitare", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin financiar nga 1.1.2013.

MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 29.8.2012
Doli nga shtypi më 30.8.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 28 lekë